



Projekt i zbatuar nga:



UDHËZUES PËR STILIN E RAPORTIMIT

PARIME MBI HARTIMIN
DHE FORMATIMIN E RAPORTEVE

REPORTING STYLE GUIDE

RULES ON WRITING AND
FORMATTING REPORTS



Funded by
the European Union

JUSTAL
Technical Assistance to Support
the Implementation of the Crosscutting
Justice Strategy in Albania

Projekt i zbatuar nga:



UDHËZUES PËR STILIN E RAPORTIMIT

PARIME MBI HARTIMIN
DHE FORMATIMIN E RAPORTEVE

Shkurt 2024

PËRJASHTIM NGA PËRGJEGJËSIA

“Udhëzues për stilin e raportimit” pasqyron mendime të ekspertëve të JUSTAL-it, të bazuara në praktikat më të mira të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian ose në standarde të tjera referimi. “Udhëzues për stilin e raportimit” përfshin vlerësime dhe rekomandime për palët e interesuara dhe në asnjë mënyrë nuk duhet kuptuar si kufizim i vendimmarrjes së pavarur dhe autonome të autoriteteve shqiptare. “Udhëzues për stilin e raportimit” nuk këshillon dhe nuk imponon asnjë detyrim të veçantë nga vendimet që janë dhënë apo marrë nga legjislacioni zyrtar, i miratuar dhe botuar në gjuhën shqipe. JUSTAL-i nuk mban përgjegjësi për saktësinë e përdorimit të informacionit vijues.



Funded by
the European Union

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
I. PARIME TË PËRGJITHSHME PËR FAQOSJEN, DREJTSHKRIMIN DHE PIKËSIMIN	10
1. Germat, titujt dhe cilësimet e paragrafëve.....	10
2. Gjatësia e fjalive	11
3. Shënimet në fund të faqes.....	11
4. Theksimi	12
5. Listat	12
6. Datat.....	14
7. Numrat dhe monedhat	15
8. Shkrimi me germa të mëdha.....	16
9. Presja	19
10. Pikëpresja.....	21
11. Vizat ndarëse.....	22
12. Shkurtime	23
13. Akronimet.....	23
14. Format e shkurtuara	24
II. REFERENCAT DHE CITIMET	25
1. Referencat.....	25
2. Referencat e përsëritura.....	28
3. Citimet	29
4. Terma latine të dalë jashtë përdorimit	31
III. PARIME TË TJERA	32
1. Fjalë të gjuhës shqipe të shkruara gabim.....	32
2. Përdorimi i fjalëve në gjuhë të huaj.....	33
3. Shprehjet në gjuhën latine	33
4. Shtetet	34
5. Faqe interneti	37

IV. RREGULLA PËR RAPORTET NË GJUHËN ANGLEZE.....	38
1. Drejtshkrimi në gjuhën angleze.....	38
2. Fjalë në gjuhën angleze që shkruhen gabim.....	38
3. Shumësi i emrave në gjuhën angleze.....	38
4. Nyja joshqese e shkurtimeve	39
5. Shkurtime në gjuhën latine.....	40
SHTOJCA 1: LEGJISLACIONI.....	41
SHTOJCA 2: LISTA E SHKURTIMEVE	52

HYRJE

“Udhëzues për stilin e raportimit”¹ është përgatitur nga Drejtoria e Politikave dhe e Strategjive në Fushën e Drejtësisë (DPSFD) dhe Drejtoria e Integritit dhe e Negociatave në Ministrinë e Drejtësisë, mbështetur nga projekti “JUSTAL” (“Asistencë teknike për mbështetjen e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri”), i financuar nga Bashkimi Evropian.

Gjatë raportimit apo hartimit të dokumenteve, drejtoritë dhe sektorët e Ministrisë së Drejtësisë përdorin mënyra jo të standardizuara. Megjithatë, njësimi i stilit të dokumenteve të nxjerra nga Ministria është jashtëzakonisht i rëndësishëm, duke pasur parasysh natyrën dhe epërsinë e tyre zyrtare, por edhe për sa i përket imazhit publik që institucioni përcjell nëpërmjet informacioneve dhe punimeve të veta. Në këtë kuadër, njësimi i stilit është shndërruar në prioritet dhe përgjegjësia për zbatimin e kësaj pune i përket pikërisht Ministrisë së Drejtësisë. “Udhëzues për stilin e raportimit” synon të shndërrohet në një mjet të dobishëm jo vetëm për drejtoritë e Ministrisë së Drejtësisë, por edhe për institucionet e saj të varësisë. Zbatimi i parimeve të shkrimit, të përmbledhura në këtë udhëzues, dhe përdorimi i stilit të duhur nga gjithë hartuesit e shkresave përkatëse, do ta përmirësojnë më tej imazhin e institucionit.

“Udhëzues për stilin e raportimit” ka si qëllim standardizimin e raportimit në fusha të ndryshme, ku institucionet raportuese, jashtë varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, përdorin stile jo të njëtrajtshme gjatë procesit të përpunimit të informacionit që i parashtrohet Ministrisë së Drejtësisë. Për këtë arsye parashikohet që “Udhëzues për stilin e raportimit” t’u shpërndahet të gjithave institucioneve raportuese, duke i ftuar të raportojnë në Ministrinë e Drejtësisë

1. “Udhëzuesi për mënyrën e raportimit” bazohet në udhëzuesin për stilin ndërinstitucional - style guide of the European Union [*“Udhëzues i stilit të Bashkimit Evropian”*], Oxford Standard Citation of Legal Authorities (OSCOLA) [*“Citimi standard i Oksfordit të autoriteteve legale (CSOAL)”*], manuali i stilit të Oksfordit, General Drafting and Layout Rules for DGs Internal and External Policies and the European Parliament [*“Rregullat e përgjithshme të hartimit dhe të planifikimit për politikën e brendshme dhe të jashtme të drejtorive të përgjithshme dhe të Parlamentit Evropian”*], si dhe English Style Guide of DG Translation [*“Udhëzues i stilit anglez të Drejtorisë së Përgjithshme të përkthimeve” të BE-së*].

në përputhje me parimet e përcaktuara aty. “Udhëzues për stilin e raportimit” inkurajohet të përdoret nga të gjitha institucionet raportuese, gjithsesi zbatimi i tij mbetet nën diskrecionin e tyre.

Për hartimin e draftit të parë “Udhëzues për stilin e raportimit”, që përmban një sërë parimesh për aspektet formale të shkrimit të raporteve dhe të dokumenteve të tjera zyrtare, përfshi, për shembull, rregullat e shenjave të pikësimit, shkurtimeve, shënimet në fund të faqes, referencat etj., u ngrit një grup pune i përbërë nga ekspertë të JUSTAL-it dhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë. Për përmirësimin e draft-dokumentit u zhvilluan raunde të shumta diskutimesh, duke u bërë disa sqarime, veçanërisht sa u përket dallimeve mes interpretimit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze dhe parimeve përkatëse të “Udhëzues për stilin e raportimit”, që kërkojnë qasje të ndryshme në të dyja gjuhët. Disa parime specifike të gjuhës shqipe, që duhet të futeshin në “Udhëzues për stilin e raportimit” e që kërkonin ekspertizë dhe njohuri të posaçme, u siguruan nga JUSTAL-i përmes pjesëmarrjes së një eksperti të gramatikës dhe të leksikut të gjuhës shqipe dhe të një redaktori.

NJËSIMI

Qëllimi gjithëpërfshirës i “Udhëzues për stilin e raportimit” është njësimi i stilit të të shkruarit dhe jo pajtimi me parime specifike gjuhësore dhe gramatikore. Si rrjedhim, parimi i njësimit duhet të jetë parimi udhërrëfyes gjatë shkrimit të raporteve apo të dokumenteve të tjera zyrtare.

Me “**njësim**” kuptohet përdorimi i një stili dhe e njëjta faqosje brenda dokumentit, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit, të pikësimit, të shkurtimeve, të akronimeve, të referencave dhe të termave të gjuhës shqipe.

Shembull:

Nëse i referoheni Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, si MSA në një pjesë të dokumentit, nuk duhet të përdorni “Marrëveshja/es” në një pjesë tjetër.

Nëse i referoheni Ministrit të Drejtësisë, si “z. Emër Mbiemër, Ministër i Drejtësisë” në një pjesë të dokumentit, nuk duhet ta ndryshoni rendin e fjalëve në pjesët e tjera të dokumentit si “Ministri i Drejtësisë, z. Emër Mbiemër”.

Nëse përdorni një shkurtim, sigurohuni që ta përdorni atë në të gjithë tekstin. Gjithsesi, kur u referoheni neneve specifike duhet të shkruani përherë “Neni/neni” si fjalë e plotë dhe jo “N” ose “n”. Gjithashtu, dispozitat duhet të shkruhen, si vijon: Neni 3, paragrafi 2, shkronja a.

Parimi i njësimi zbatohet edhe në përdorimin e numrave dhe të shkronjave në lista. E njëjta gjë zbatohet edhe për distancat dhe ndarjet në paragrafë. Duhet të përdoret e njëjta distancë mes rreshtave. Veç kësaj, sigurohuni që paragrafët të kenë të njëjtin stil dhe shmangni përdorimin e stileve të ndryshme brenda të njëjtit paragraf.

Njësimi vlen edhe për citimet dhe listat e referencave. Pra, për t’u siguruar që dokumenti i shkruar të paraqesë përpjekjet më të mira të autorit, njësimi duhet të ruhet përgjatë gjithë përmbajtjes së materialit.

“Udhëzues për stilin e raportimit” është redaktuar dhe përditësuar në janar 2024.

I. PARIME TË PËRGJITHSHME PËR FAQOSJEN, DREJTSHKRIMIN DHE PIKËSIMIN

1. Germat, titujt dhe cilësimet e paragrafëve

Teksti i raportit duhet të respektojë medoemos këto elemente:

Germa duhet të jetë “Times New Roman”. Madhësia e germës duhet të jetë 12-she dhe të ruhet distanca 1.15 midis rreshtave. Në të djathtë dhe të majtë të faqes lihet një marzhë prej 3 cm bosh, ndërsa në krye dhe në fund të faqes hapësira duhet të jetë 2 cm.

Përpiquni të përdorni paragrafë të shkurtër dhe lini gjithmonë një hapësirë boshe (*enter*) midis paragrafëve.

Titujt duhet të jenë sa më koncizë e të qartë dhe duhet të ndjekin një rrjedhë logjike. Nuk lejohet përdorimi i shkurtimeve (të panjohura) në tituj.

Shmangni vendosjen e pikës në fund të titujve.

Parime të veçanta për titujt

Gjatë hartimit të një dokumenti duhet të ndiqni disa parime të veçanta në lidhje me titujt. Kur vendosni hapësira (*enter*) para dhe/ose pas titujve, përdorni të njëjtin stil shkrimi të teksit.

TITULLI KRYESOR pa numërtim (niveli 1)

Gjithmonë fillon në faqe të re; 2 hapësira (*enters*) pas këtij titulli.

¶

¶

1. TITULL (niveli 1)

Gjithmonë fillon në faqe të re; 2 hapësira (*enters*) pas këtij titulli.

¶

¶

1.1 TITULL (niveli 2)

2 hapësira (*enters*) para dhe 1 hapësirë (*enter*) pas këtij titulli.



1.1.1 Titull (niveli 3)

1 hapësirë (*enter*) para dhe 1 hapësirë (*enter*) pas këtij titulli.



1.1.1.1 Titull (niveli 4)

1 hapësirë (*enter*) para dhe 1 hapësirë (*enter*) pas këtij titulli



2. Gjatësia e fjalive

Përpiquni të përdorni fjali pak a shumë të shkurtra. Fjalitë këshillohet të mos i kalojnë më shumë se 15-20 fjalë (mesatarisht).

3. Shënimet në fund të faqes

Shënimet në fund të faqes (*footnotes*) nuk shërbejnë si hapësirë për bisedë, as për përcjelljen e kundërargumenteve interesante. Shënimet shërbejnë për të cituar burimin ku jeni mbështetur për të hartuar dokumentin dhe, në disa raste, për identifikimin e burimeve plotësuese shtesë. Si rregull nuk këshillohet të bëhen shënime të dendura dhe të gjata. Megjithatë, nëse lind nevoja, për këtë rregull mund të bëhen edhe përjashtime.

- Vendosni gjithmonë numrin e shënimit pas një hapësire dhe para shenjës së pikësimit.

Shembull:

Përdorni “(1).” dhe jo “. (1)”

- Shënimi në fund të faqes fillon me shkronjën e parë të madhe, me përjashtim të rastit kur fjala e parë është një shkurtim konvencional me shkronjë të vogël.

- Shmangni përsëritjen e konstantes “Shih”, pasi shënimi e nënkupton vetvetiu këtë udhëzim për lexuesin.
- Shënimi përfundon me pikë, përveçse kur fjalitë mbarojnë me pikëpyetje ose pikëçuditëse.

Shembull:

³⁴Ecuria e këtij procesi varet nga akordimi i fondeve.

⁴⁶Objektivi Specifik 4.1: 20 000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit.

4. Theksimi

- Për të theksuar një fjalë, grup fjalësh ose fragment, përdorni *germa kursive* ose **me të zezë**. Shmangni nënvizimin e fjalëve.
- Megjithatë nuk këshillohet përdorimi i tepërt i asnjërës prej dy mënyrave. Kështu, për të shmangur përdorimin e shpeshtë të *kursiveve* (në funksion të numrit të dhënë me *shkronja kursive*), hera-herës mund të përdorni fjalë të theksuara **me të zezë**.
- Shmangni theksimin e fjalëve ose të fjalive në shënimet në fund të faqes. Shënimet shërbejnë për të përcaktuar burimet ose për komente plotësuese, për këtë arsye çdo theksim i nevojshëm bëhet në tekst.

5. Listat

Përdorni **numra**, **rrethorë të zinj** (●), **këpushë** (√) ose **viza** (-) dhe mundohuni të shmangni shenja të tjera si kryqe apo lule.

Parime të përgjithshme:

- Përdorni pajisjet e numërimit automatik të kompjuterit (në “Word”, “Excel” etj.), pasi është shumë më e lehtë ndryshimi i elementeve në listë nëse numrat renditen automatikisht.
- Çdo paragraf i listës duhet të ndjekë rrjedhën logjike të shprehjes në parathënie.

- Kur të përktheni listat, përdorni të njëjtin stil numërtimi si në tekstin original; p.sh., shkronja të vogla (a,b,c., etj.), numra romakë, pika, viza etj.
- Në listat me shumë nivele, zbatoni të njëjtat rregulla për çdo nivel.

Shembuj listash

- a) Në listën ku çdo element plotëson fjalinë e parathënies, ky i fundit duhet të pasohet nga dy pika (:). Secili element duhet të etiketohet me shenjë përkatëse, numrin ose shkronjën dhe duhet të përfundojë me pikëpresje, me përjashtim të elementit të fundit, i cili duhet të përfundojë me pikë.

Shembull:

Raporti paraqet:

- arritjet kryesore të secilit institucion;
- analizën e ecurisë së zbatimit të synimeve të politikave;
- prezantimin e rezultateve mbi zbatimin e masave;
- vlerësimin në lidhje me përmbushjen e objektivave specifike.

- b) Në listën ku nuk ka një rrjedhë logjike me fjalinë e parathënies, kjo e fundit duhet të pasohet nga dy pika (:). Çdo element në listë fillon me shkronjë të vogël, etiketohet me shenjë, numrin dhe shkronjën përkatëse dhe përfundon me pikëpresje, përveç elementit të fundit, i cili duhet të përfundojë me pikë.

Shembull:

Shkalla e zbatimit të masave përcaktohet në bazë të intervalit:

- kur masa e veprimit është realizuar 100% konsiderohet si **“e realizuar”**;
- kur masa e veprimit është pjesërisht e realizuar dhe/ose gjatë periudhës së raportimit vijon të realizohet në 50%-99% konsiderohet si **“pjesërisht e realizuar”**;
- kur masa e veprimit nuk ka regjistruar zhvillim gjatë periudhës së raportimit ose nuk ka pasur përparim (vlerësimi i raportuar 0%-49%) konsiderohet si **“e porealizuar”**.

- c) Në listat ku të paktën një nga elementet përbëhet nga disa fjali të plota, lista duhet të paraqitet me një fjali të plotë pasuar nga dy pika. Çdo element në listë duhet të fillojë me shkronjën e parë të madhe, të etiketohet me shenjën, numrin apo shkronjën përkatëse dhe duhet të përfundojë me pikë. Aspekti i fundit lejon, që, në një element të vetëm, të përfshihen disa fjali për të shmangur përdorimin e disa shenjave të pikësimit.

Shembull:

Arritjet e poshtëshënuara do të konsiderohen si veprime konkrete drejt realizimit të synimit të politikave:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Inspektori i Lartë të Drejtësisë kanë përgatitur analiza lidhur me strukturën e tyre ligjore përkatëse dhe kanë propozuar amendamentet e nevojshme në lidhje me ligjin e Statusit, ligjin e Qeverisjes, si dhe të ligjeve të tjera përkatëse.
- Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm urdhrash dhe aktesh administrative që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e brendshëm të kësaj zyre, për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e veprimtarive dhe shërbimeve të ofruara.
- Pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës, në vitin 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kanë emëruar përkatësisht 23 gjyqtarë dhe 22 prokurorë të rinj.
- Inspektori i Lartë të Drejtësisë kreu 3 inspektime tematike bazuar në një metodologji të miratuar. Dy prej tyre kanë përfunduar dhe rezultatet e relacioneve u janë dërguar institucioneve përkatëse për zbatimin e rekomandimeve.

6. Datat

- Datat duhet të shkruhen përherë të plota.

Shembull:

31 janar 2023 dhe jo 31.01.23 (apo shkurtime të ngjashme)

- Datat e akteve ligjore duhet të shkruhen me numra arabë.

Shembull:

Ligji nr. 8678, datë 14.05.2001.

- Ditët dhe muajt njëshifror duhet të shkruhen me 0 përpara.

Shembull:

04.06.2023 dhe jo 4.6.2023

7. Numrat dhe monedhat

- Kur të shkruani numrat si numërorë përdorni sistemin e mëposhtëm: vendosni një presje para treshifrorëve të fundit (kur kemi të bëjmë me numër më të madh se 999) dhe para gjashtëshifrorëve të fundit etj.

Shembull:

2,400; 78,000; 120,000; 1,000,000.

- Përdorni pikë, asnjëherë presje, për të ndarë njësitë nga nënnjësitë.

Shembull:

7.2; 50.75; 1,324.5; 2.4 milionë.

- Në gjuhën shqipe shkurtimi i simbolit të monedhës ose simboli i monedhës vendoset pas shumës.

Shembull:

2 milionë euro

2000 EUR

200€

- Në gjuhën angleze vendosni shkurtimin e emërimit të monedhës ose simbolin e monedhës përpara shumës.

Shembull:

EUR 1.50; EUR 2,400 – kujdes hapësirën midis shkurtimit të simbolit të monedhës dhe shumës përkatëse.

£78,000; €120,000 – kini parasysh se midis simbolit dhe shumës nuk kemi hapësirë.

- “euro”, “paund”, “dollar” dhe çdo emërtim tjetër monedhe në anglishte shkruhen me shkronja të vogla, shkronja e parë nuk fillon me të madhe.
- “lekë” gjithashtu shkruhet me shkronja të vogla dhe shkronja e parë nuk fillon me të madhe. Simboli për lekun shqiptar është ALL (lekë).

Përdorimi i fjalëve dhe përdorimi i shifrave

- Shkruani “një” me përjashtim të rasteve kur konteksti ju sugjeron të shkruani “1” (referencë në ligj, në indeks apo në rrethana të tjera). Të gjithë numrat e tjerë shkruhen me shifra (përfshi 2 deri në 9), përveç rasteve kur janë pjesë e një togfjalëshi të zakonshëm, si “një ose dy prej tyre” ku numrat do të ngjanin të papërshtatshëm.
- Nëse fjalia fillon me një numër, shkruajeni atë me shkronja.

Shembull:

Shtatë ligje u miratuan brenda vitit 2023.

Tetëmbëdhjetë institucione morën pjesë në konferencën 2-ditore organizuar në MD.

- Shifrat (arabe ose romake) përdoren për shekujt, kur kemi të bëjmë me një periudhë që paraqet sasi, numër, grupmoshë etj., për numra seksionesh, klauzolah, paragrafësh etj., si dhe kudo ku përdorimi i fjalëve do të dukej i pavend.

Shembull:

“24 ditë”; “shekulli i 20-të”, “shekulli V”

“fëmijë të grupmoshave 7-12-vjeç”

“në seksionin 5,13 dhe 45”

8. Shkrimi me germa të mëdha

- Sipas parimit kryesor, emrat e përveçëm fillojnë gjithmonë me shkronjë të madhe, ndërsa emrat e përgjithshëm me të vogël.

- Shkronja e parë e emrave dhe e mbiemrave shkruhet me të madhe, kur u referoheni emërtimeve të organizatave, institucioneve, drejtorive, njësive, seksioneve, titullarëve, komiteteve, emërtimeve të funksioneve zyrtare apo shoqërore etj. (me përjashtim të fjalive dhe fjalëve ndihmëse/parafjalëve). Megjithatë përdorni shkronjën e vogël, kur u referohemi, në përgjithësi, emrave të funksioneve shtetërore, drejtorive të përgjithshme të paemërtuara, seksioneve ose njësive.

Shembull:

- “Ministri i Drejtësisë”, por “ministrat përgjegjës për raportimin janë...”
 - “presidenca e Këshillit (e përgjithshme), por “Presidenca Gjermane (si një presidencë e veçantë)
 - “Neni 27 i KEDNJ”; por “të gjitha nenet e këtij ligji janë...”
 - i nderuar Deputet (i Parlamentit Evropian)
 - Drejtoria e Politikave dhe e Strategjive në Fushën e Drejtësisë
 - Drejtoria e Integritetit dhe e Negociatave
 - Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit
 - Sektori i Integritetit Evropian
 - Fondi Evropian i Zhvillimit
 - zëvendëskryetar i Komitetit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare
- Emërtimet e organeve të përhershme shkruhen me shkronjë të madhe, ndërsa grupet *ad hoc* shkruhen me të vogël.

Shembull:

“Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri”, por “delegacioni polak në një takim...”.

Në këtë kuadër, emërtimet e gjata që ngjajnë më shumë si përshkrime sesa si tituj të vërtetë shkruhen me shkronjë të madhe vetëm fjala e parë, kurse fjalët e tjera vijnë me të vogël.

Shembull:

Grupi tematik për drejtësinë penale.

- Fjalët e emrave të marrëveshjeve ndërkombëtare, të konferencave,

konventave etj., shkruhen me shkronja të mëdha.

Shembull:

- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit;
- Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë;
- “Marrëveshja e Përgjithshme për Taksat dhe Tregtinë”, por nëse u referoheni sërish “marrëveshja”, “konferenca” etj., atëherë shkruhet me shkronjë të vogël.

- Kur i referoheni një legjislacioni specifik, lloji i aktit ligjor shkruhet me shkronjën e parë të madhe. Megjithatë, përdoret shkronja e vogël kur u referoheni akteve ligjore në përgjithësi.

Shembull:

“Kushtetuta”, ligji nr., rregullorja nr., vendimi nr., direktiva nr., shtojca nr., dhe neni nr. (pasuar nga një numër)”, por duhet të shkruani “rregulloret e BE-së”.

- Mbani parasysh se fjalët “projekt” (“draft”) dhe “propozim” duhet të shkruhen me shkronja të vogla edhe në titujt e projektligjeve.

Shembull:

Në gjuhën angleze:

According to the draft law “On some additions and amendments in the Law no. 9695, dated 19.3.2007 “On the adoption procedures and the Albanian Committee of Adoption”, as amended”

Në gjuhën shqipe:

“Sipas projektligjit ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 ‘Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit’, i ndryshuar’...”

9. Presja

- Në gjuhën shqipe presja përdoret për të lidhur fjalë, togfjalësha apo fjali që bashkohen me lidhëzën kundërshtore “por” ose në disa raste me lidhëzat “as/edhe”.

Shembull:

- Grupi i punës *ad hoc* përgatiti draftin e parë të rregullores, por Këshilli nuk e ka shqyrtuar ende atë.
- Grupi i punës *ad hoc* nuk e ka përgatitur ende draftin e parë, as Këshilli nuk ka marrë masa për ecurinë e tij.

- Nuk vihet presje kur lidhen fjalë, togfjalësha apo periudha me lidhëzat bashkërenditëse ndarëse “ose”, “apo”.

Shembull:

Grupi i punës *ad hoc* do të përgatitë një draft të parë dhe do ta diskutojë atë me Drejtorin e Drejtorisë ose do ta dërgojë menjëherë për miratim në Këshill.

- Presja përdoret për të ndarë fjalë ose togfjalësha të zgjeruar ose plotësues me fjalë të tjera.

Shembull:

- Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e projektit JUSTAL, ka përgatitur një udhëzues për hartimin e raporteve të kërkuara...;
- Në periudhën vijuese, përkatësisht gjatë 20-30 nëntorit, do të zhvillohen prezantime mbi udhëzuesin e hartimit të raporteve...

- Presja përdoret kur një fjalë, një grup fjalësh apo fjali të ndërmjetme ndihmojnë për të radhitur argumentet, për t'i përforcuar apo për të provuar mbështetjen juridike.

Shembull:

Së pari, ...; së dyti,
në të vërtetë, ...;

shkurtimisht, ...;
sipas Kushtetutës,...;
sipas ligjit,

- Presja përdoret për të lidhur fjalë apo grupe fjalësh të njëpasnjëshme. Në këtë rast presja luan rolin e lidhëzave munguese “dhe” ose “e”.

Shembull:

- Ministria e Drejtësisë është institucioni udhëheqës për SND-në, institucionet e tjera janë përgjegjëse për raportimet periodike mbi zbatimin e SND.
- Komiteti shqyrtoi ligjet kombëtare, ndërkombëtare bilaterale dhe multilaterale.

- Presja ndarëse mund të përdoret para lidhëzës “dhe” (ose “ose”), nëse kemi nevojë për të theksuar apo sqaruar diçka.

Shembull:

Përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse në trajnim u pajisën me certifikata, dhe u ftuan të merrnin pjesë në sesionin e radhës.

- Nuk vihet presje para shkurtimit etj. (e të tjera) në fund të një renditjeje.

Shembull:

Pjesëmarrësit diskutuan rreth arritjeve, sfidave, hapave të mëtejshëm etj. të SND-së 2021-2025.

Mirëpo, në rast se nuk kemi të bëjmë me një radhitje logjike ngjarjesh, atëherë para formës së shkurtuar “etj.” mund të vendoset presje.

Shembull:

Përfaqësuesit e institucioneve vartëse, si Drejtoria e Përgjithshme e Ndihmës Juridike Falas etj., morën pjesë në Tryezën e Rrumbullakët të zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë.

- Gjithashtu presja shërben për të veçuar mbiemrat në një renditje të njëpasnjëshme. Mirëpo, presja nuk përdoret nëse mbiemrat nuk formojnë një radhitje rendore.

Shembull:

Standardet ishin gjithëpërfshirëse, demokratike dhe të qarta.

Standardet demokratike gjithëpërfshirëse përcaktohen në Nenin 1 të ligjit.

Në shembullin e dytë, “gjithëpërfshirëse” zbut “standarde demokratike”, pra fjalia nuk mund të lexohet “standarde demokratike dhe gjithëpërfshirëse”.

Shënim: Shmangni përdorimin e dendur të presjeve në fjali. Formoni fjali që minimizojmë përdorimin e presjeve, për shembull, duke i ndarë fjalitë e përbëra në dy ose në më shumë fjali të thjeshta.

10. Pikëpresja

- Pikëpresja i ndan grupet e fjalëve dhe fjalitë më qartë se presja, por disi më pak se pika.
- Për të lidhur dy apo më shumë fjali pa lidhëza me njëra-tjetrën përdorni pikëpresje dhe jo presje në rastet kur fjalia e fundit theksohet apo vjen si informacion shtesë a përmyllës.

Shembull:

Komisioni që merret me emetimin e ligjeve qeverisëse miratuan tekstin përfundimtar; megjithatë kapitulli mbi të drejtat e njeriut nuk u diskutua.

- Pikëpresjet mund t’i përdorni gjithashtu në vend të presjes, për të renditur çështjet, veçanërisht në fjalitë që përmbajnë presje.

Shembull:

Komitetit i duhet të hartojë ende udhëzimet, urdhrat dhe rregulloret; një raport paraprak, afatmesëm dhe përfundimtar; si dhe duhet të dërgojë dokumentet për shqyrtim në drejtoritë përgjegjëse.

- Mund të përdorni pikëpresjen në renditjen e akteve zyrtare (shoqëruar ose jo me numra, në seri ose në vijimësi) fakte të shprehura me fjali të thjeshta ose të përbëra, në brendësi të të cilave mund përdoret presja.

Shembull:

Në muajin dhjetor, Parlamenti miratoi 3 ligje; 5 udhëzime; 7 urdhra; 2 akte normative dhe diskutoi mbi projektligjin... .

11. Vizat ndarëse

- Vizat Em (vizat e gjata “—”) përdoren si shenja pikësimi, në vend të kllapave. Vizat forcojnë kontrastin, theksimin e një fjale apo të një togfjalëshi, si dhe risjellin në vëmendje informacione të njohura. Megjithatë, nuk këshillohet të përdoret më shumë se një në një fjali, përveç rastit të fjalive të përbëra.

Shembull:

Këshilli i Lartë Gjyqësor—më parë Këshilli i Lartë i Drejtësisë—ka marrë masat e nevojshme për të garanuar...

- Viza e gjatë përdoret, gjithashtu, për të treguar periudha kohore.

Shembull:

janar—maj
periudha pranverë—vjeshtë
vitet 2022—2023
shekujt XX—XI

- Vizat *En*. (vizat e shkurtra “–”) përdoren për të lidhur çifte fjalësh bashkërenditëse dhe krahasuese.

Shembull:

itinerari Bruksel–Paris
grafiku i rrymë-voltazhit
raporti gjatësi-thellësi

- Viza e shkurtër përdoret, gjithashtu, pas pjesëzës “ish”, që vendoset përpara emërtimeve të ndryshme.

Shembull:
ish-ministër,
ish-zëvendësministër.

12. Shkurtime

- Shkurtime duhet të citohen dhe shpjegohen në listën/tabelën përkatëse të shkurtimeve.
- Herën e parë që përdorni një shkurtime shkruajeni të plotë dhe, më pas, vendoseni shkurtime në kllapa.

Shembull:
Objektiva specifike (OS).

- Nëse nuk është e nevojshme mos përdorni shkurtime.
- Shkurtime “për shembull” duhet të vijohet nga një “pikë”, por nuk shoqërohet me presje.

Shembull:
p.sh.

Shënim. Nëse një listë fillon me “p.sh.” mos e përfundoni me “etj.”

- Për të lehtësuar procesin e përgatitjes dhe për t’i ardhur në ndihmë lexuesit, lista/tabela e shkurtimeve të çfarëdolloj raporti duhet të përfshihet në parathënie të dokumentit. Numri i shkurtimeve duhet të përkojë me natyrën dhe gjatësinë e raportit. Lutemi, ndiqni rendin alfabetik kur të pasqyroni shkurtime.

13. Akronimet

- Akronimi ndryshe nga shkurtime është një varg shkronjash ose rrokjesh që shqiptohen si një fjalë e plotë.

- Midis shkronjave të akronimeve nuk vendoset pikë: SND, NATO, OSBE/ODIHR, BE etj.
- Akronimet funksionojnë si fjalë (emra) dhe si të tilla ato mund të nisin fjali dhe nëse akronimi është me shkronja të vogla, germa e parë shkruhet me të madhe.

Për akronimet kryesore (shkurtime) të përdorura në raportet në gjuhën shqipe, shihni Shtojcën II.

Sa u përket akronimeve kryesore (shkurtime) që lidhen me BE-në, shihni: <http://publications.europa.eu/code/en/en-5000400.htm>

14. Format e shkurtuara

- Shmangni shkrimin e formave të shkurtuara në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe.

Shembull:

- Shkruani “does not”/“nuk bën”, jo “doesn”t”/“s’bën”;
- Shkruani “cannot”/“nuk mundet” jo “can”t”/“s’mundet”;
- Shkruani “will not”/ “nuk do të” jo “won”t”/ “s’do të”.

Megjithatë format e shkurtuara përdoren për titujt civilë. Kur titujt shkruhen në anglishte nuk përdoret asnjëherë “pikë” në fund. Përjashtim bën vetëm shkurtimi i fjalës “Professor”, i cili bëhet “Prof.”

Shembull:

Shkruani “Mr”, jo “Mr.”,
Shkruani “Mrs”, jo “Mrs.”.

- Në gjuhën shqipe duhet të përdorni pikë për titujt civilë.

Shembull:

“Z.”, jo “Z”,
“Znj.”, jo “Znj”,
“Prof.” dhe jo “Prof” .

II. REFERENCAT DHE CITIMET

1. Referencat

Parime të përgjithshme mbi referencat lidhur me shënimet në fund të faqes

- Titujt e raporteve, të dokumenteve, të librave dhe të gazetave shkruhen me shkronja kursive.
- Titujt e botimeve shkruajini në gjuhën angleze/shqipe nëse ekziston versioni zyrtar në gjuhën angleze/shqipe.
- Titujt e dokumenteve që janë shfaqur vetëm në një gjuhë të huaj nuk përkthehen.

Raportet nga agjencitë, institucionet dhe organizatat

- Emërtoni agjencinë/organizatën/institucionin me shkronjën e parë të madhe pasuar nga presja; emri i departamentit raportues kur është e zbatueshme; titulli i raportit me germa kursive; data; faqet përkatëse (kur është e zbatueshme); dhe URL.

Shembull:

Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Politikave dhe i Strategjive në Fushën e Drejtësisë, *Report on Cross Sector Justice Strategy for the Period January-June 2022* [“Raporti Vjetor i Monitorimit mbi Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për periudhën janar – qershor 2022”], mars 2022, f. 30-45 www.drejtësia.gov.al

- Nëse nuk dihet viti i botimit shënoni (n.d.), forma e shkurtuar për “nuk ka datë”.
- Për raportet në formë të printuar hiqet informacioni për URL-në.
- Termat e përdorur në referenca (për shembull: botues, kapitull, botim) përcaktohen nga gjuha e tekstit të shkruar dhe jo nga gjuha e burimit.

Dokumentet e fletoreve zyrtare të Bashkimit Evropian

Shembull:

OJ C 137, 27.5.2010.

OJ C 137 A, 27.5.2010, p.1.

Referenca për legjislacionin e BE-së

- Pjesë të ndryshme të titullit të plotë të një akti (titull, numër, autor, datë dhe subjekti i titullit) nuk ndahen me presje dhe emërtimi nuk pasohet nga presje.

Shembull:

Rregullore (EEC) 2658/87 ...

Rregullore Këshilli (KE) 1186/2009 ...

Rregullorja e Komisionit (BE) 1204/2009 e ndryshuar me Rregullore (KE) 968/2006 formulon rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) 320/2006 duke krijuar një projekt të përkohshëm për ristrukturimin e industrisë së sheqerit në Union ...

Rregullore (KE) 1/96 dhe 2/96, ...*(akte të lëshuara nga e njëjta marrëveshje)*

Rregulloret (KE) 1/96 dhe 2/96 dhe (Euratom) 3227/76, ... *(akte të lëshuara nga marrëveshje të ndryshme)*

Rregulloret (BE) 1188/2009 deri më 1191/2009, ...

Shembull në fjali:

Rregullore (BE, Euratom) 883/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për hetimet e kryera nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) 1073/1999 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe Rregullores së Këshillit (Euratom) 1074/1999, (OJ L 248, 18.9.2013).

Referenca për çështje para gjykatave të BE-së

Raportet e gjykatave evropiane

Shembull:

Çështja 52/84 *Komisioni kundër Belgjikës* [1986] ECR 89, paragrafi 12.

Çështja T-45/90 *Speybrouck kundër Parlamentit* [1992] ECR II-33, paragrafi 2.

Çështja T-3/92 *Latham kundër Komisionit* [1994] ECR-SC I-A-23 dhe II-83.

Dokumente të papublikuara dhe të regjistruara në një seksion të veçantë të raporteve të Gjykatës Evropiane

Shembull:

Vendimi i 31 janarit 2008 për çështjen C-147/07 *Komisioni kundër Francës*, paragrafi 2.

Në punime të tjera, rekomandohet që të përfshihet **data e vendimit** dhe **viti i raportit të trupit gjykues** për të lehtësuar kërkimin bibliografik për lexuesin, i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht në dijeni të lidhjes midis vitit të botimit dhe vitit të vendimit.

Shembull:

Përpara datës 15 nëntor 1989:

Vendimi i 15 janarit 1986 në çështjen 52/84 *Komisioni kundër Belgjikës* (ECR 1986, p. 89, paragrafi 12).

Pas datës 15 nëntor 1989 - raportet e çështjeve pranë Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme, të publikuara veçmas:

Vendimi i 30 janarit 1992 në çështjen C-328/90 *Komisioni kundër Greqisë* (ECR 1992, p. I-425, paragrafi 2).

Vendimi i 28 janarit 1992 në çështjen T-45/90 *Speybrouck kundër Parlamentit* (ECR 1992, p. II-33, paragrafi 2).

Prej vitit 1994 (çështje personeli):

Vendimi i 9 shkurtit 1994 në rastin T-3/92 Latham kundër Komisionit (ECR-SC 1994, p. I-A-23 dhe II-83, paragrafi 2).

Prej vitit 2006 - çështje personeli para Gjykatës së Drejtësisë, Gjykatës së Përgjithshme dhe Gjykatës së Shërbimit Civil:

Vendimi i 9 nëntorit 2006 në çështjen C-344/05 P Komisioni kundër De Bry-it (ECR-SC 2006, f. I-B-2-19 dhe II-B-2-127).

Vendimi i 8 qershorit 2006 në çështjen T-156/03 Perez-Diaz kundër Komisionit (ECR-SC 2006, f. I-A-2-135 dhe II-A-2-649).

Vendimi i 26 tetorit 2006 në çështjen F-1/05 Landgren kundër ETF-së (ECR-SC 2006, f. I-A-1-123 dhe II-A-1-459).

2. Referencat e përsëritura

- Referenca e përsëritur nuk riprodhon të gjithë informacionin lidhur me pjesën e përmendur, por e dërgon lexuesin në pasazhin ku informacioni përkatës është dhënë për herë të parë, qoftë në tekst apo në një shënim në fund të faqes.

Shembull për referencë lidhur me shënimet në fund të faqes.

Për referencë fillestare: McGhee, J., (ed) *Snell's Equity* (30th edn, Sweet & Maxwell, London, 2000).

Për referencat e përsëritura vijuese: *Snell's Equity* (n 16) 42–45.

- Referencat e përsëritura përdoren në rastet kur teksti i raportit i referohet:
 - një teksti në të njëjtin raport (referencë e brendshme); ose
 - një teksti në një dokument tjetër (referenca e jashtme).
- Shmangni dërgimin e lexuesit në një pjesë tjetër të dokumentit, kur mund ta riformuloni fare lehtësisht vetë një shënim të shkurtër.
- Mos bëni asnjëherë një referencë të tërthortë e të vështirë për t'u gjetur nga lexuesi. Një referencë e mirëpërsëritur e çon lexuesin drejt e në vendin e duhur.

Shembull 1 dhe 2 nuk janë referenca të qarta. Këshillohet të përdoren referenca të ngjashme me shembullin 3.

1. “Shihni më lart” - nuk është i dobishëm.
2. “Shih kapitullin VII të lartpërmendur” - as kjo nuk është më e qartë.
3. “39”ose brenda kapitullit,“Seksioni Reforma e Drejtësisë, faqe 39”.

- Mos harroni se numërtimi i faqeve ndryshon nga drafti në draft ndaj kujdesuni të referoni faqet e sakta.

3. Citimet

Informacioni i cituar ndjek me përpikëri burimin nga është përmendur. Stili nuk duhet ndryshuar sipas dëshirës. Për më tepër, nuk duhet të bëhet asnjë ndryshim, sado i vogël, vetëm në rast se cilësohet me një shënim në fund të faqes apo shënjohet me tregues konvencional. Nëse në origjinal përdoret drejtshkrim ose shenja të çuditshme pikësimi, nuk keni nevojë të bëni shënime. Fakti që po e citoni tregon se është cituar njëlloj nga origjinali.

Parime të përgjithshme:

- Kur kemi të bëjmë me citat të gjatë, dy ose tre paragrafë, paragrafi fillon me thonjëza (“), por thonjëzat përmbyllëse vihen vetëm në fund të tekstit të cituar.
- Thonjëzat njëshe (‘) përdoren nëse vendosen brenda një teksti të mbyllur me thonjëza.
- Germa duhet të jetë e njëjta me madhësinë e germës së tekstit, jo më e vogël.
- Pikat dhe shenjat e tjera të pikësimit në fund të civateve duhet të vendosen jashtë thonjëzave, përveç rasteve kur janë pjesë e civateve.

Shembull:

Ministri i Drejtësisë tha: “Nga 15 objektivat specifike u arritën në total 13 prej tyre ‘një arritje e konsiderueshme krahasuar me vitin e mëparshëm’ dhe 4 nga 5 masat u zbatuan”.

Shënim: Thonjëzat janë shenja grafike që tregojnë se fjalët ose fjalitë e përfshira në to nuk kanë të njëjtën natyrë me tekstin. Në praktikën e shtypshkrimit përdoren dy lloje thonjëzash: tradicionalet (« ») dhe më të rejat (“”). Këto të fundit mund të jenë dyshe ose njëshe.

Shkronja e parë e citatit

- Kur një citat i gjatë paraprihet nga dy pika ose nga pika, shkronja e parë e citatit duhet të shkruhet me shkronjë të madhe.
- Nëse citati nuk paraprihet nga një presje apo nga ndonjë shenjë pikësimi tjetër, shkronja e parë e citatit shkruhet me të vogël.
- Kur qasja me këto parime kërkon që të ndryshohet shkronja e parë e citatit, atëherë vendoseni mes kllapave.

Heqja e fjalëve nga citati

- Nëse një citati i heqim fjalë të caktuara, atëherë ato zëvendësohen me një shumëpikësh (tri pika).
- Nëse hiqen fjalët vijuese të një fjalie, atëherë ato zëvendësohen me një shumëpikësh.
- Nuk është e nevojshme të vendosni pikë pas shumëpikëshit, për të treguar se aty janë hequr fjalët që përfundojnë fjalinë.
- Asnjë shumëpikësh nuk përdoret në fillim të një citati. Nëse, sipas citatit, duhet që shkronja e parë të fillojë me të madhe, kllapat tregojnë se fjalët paraprake janë lënë jashtë.

Shembull:

“Nëse periudha do të kishte qenë një ditë ose një javë, mund të ishte sugjeruar se efekti i volitshëm dhe thelbësor i seksionit ishte zvogëlimi

i shkaqeve të veprimit. ...Mendoj se është e pamundur të thuhet se periodha njëvjeçare është e arsyeshme”.

“(F)unksioni i tyre duket të jetë jo më shumë sesa ... ofrimi i një baze më të qartë për shpjegimin, vlerësimin dhe zhvillimin e doktrinave të veçanta të së drejtës së zakonshme. ... Shumë më i rëndësishëm ... është ndikimi që duhet të kenë si parime kushtetuese në strukturimin dhe praktikën e qeverisjes...”.

4. Terma latine të dalë jashtë përdorimit

Tashmë të gjitha këto fjalë: supra, infra, ante, id, op cit, loccit, contra sugjerohen të mos përdoren. Dikur përdoren rëndom në citime të përsëritura, por prej kohësh është dakordësuar gjerësisht moszbatimi i tyre dhe po lindin gjithnjë e më shpesh keqkuptime.

- “ibid.” (“po aty”) që është një shkurtim i “ibidem” dhe do të thotë “në të njëjtin vend” lejohet ende, por vetëm për të përsëritur një citim që jepet më sipër.
- Kur përdoret më vete “ibid.” nënkupton saktësisht “në të njëjtin vend”, ndërsa “ibid. 345” do të thotë “në të njëjtën vepër, por këtë herë në faqen 345”.
- “ibid.” nuk fillon asnjëherë me shkronjë të madhe.
- “cf.” (“krahaso”) lejohet për të drejtuar lexuesin te një vepër e ngjashme.

III. PARIME TË TJERA

1. Fjalë të gjuhës shqipe të shkruara gabim

Më poshtë, po rendisim disa fjalë të gjuhës shqipe, të cilat shpesh shkruhen në mënyrë të gabuar. Tregoni kujdes gjatë drejtshkrimit të tyre.

<i>E gabuar</i>	<i>E saktë</i>
Agjensi	Agjenci
Axhent	Agjent
Antar	Anëtar
Cënoj	Cenoj
Çertifikatë	Certifikatë
Dakort	Dakord
Defiçit	Deficit
Dixhitalizim	Digjitalizim
Efiçencë	Eficensë
Gjithshka	Gjithçka
Gjyqëtar	Gjyqtar
Gjyqsor	Gjyqësor
i sigurtë	i sigurt
Konçension	Koncesion
Marrdhënie/Mardhënie/Marrë dhënje	Marrëdhënie
Pashaportë	Pasaportë
Pavion	Pavijon
Proçes	Proces
Qera	Qira
Vënd	Vend
Sërisht	Sërish
Standart	Standard

2. Përdorimi i fjalëve në gjuhë të huaj

- Në varësi të gjuhës së raportit, fjalët dhe shprehjet që janë në gjuhë të huaj shkruhen me shkronja *kursive* dhe, nëse është e nevojshme, përkthehen më pas në kllapa.
- Këto fjalë vendosen në thonjëza vetëm nëse nevojitet përdorimi i fjalëve në gjuhën angleze.
- Mos përdorni njëkohësisht edhe shkronja *kursive*, edhe thonjëza.

Shembull:

Në gjuhën shqipe: Në këtë fazë synohet eliminimi i *backlog*-ut (çështjet e mbartura për më shumë se një vit) dhe rritja e cilësisë së shërbimeve, duke u ofruar e njëjta drejtësi si në nivelin e vendeve të BE-së.

Në gjuhën angleze: The building called *Poli i Drejtësisë* (Justice Pole) became functional 2 years ago.

3. Shprehjet në gjuhën latine

Shprehjet e mëposhtme përdoren në raportet në gjuhën angleze.

- Fjalët më të përdorura në gjuhën latine shkruhen me shkronja *kursive*.

Shembull:

- *inter alia* (ndër të tjera)
- *pro forma* (për hir të formës)
- *per diem* (për ditë)
- *ad infinitum* (pa limit)
- *status quo* (gjendja ekzistuese)

Përdorimi i termave dhe i shprehjeve latine duhet të jetë sa më i rrallë, në vend të tyre përdorni termat përkatës në gjuhën shqipe (ose në gjuhën angleze kur hartoni një raport në këtë gjuhë). Më poshtë, citohen disa nga termat më të zakonshëm:

Latinisht	Shqip
mutatis mutandis	me ndryshimet përkatëse
ex lege	për shkak të ligjit
ex officio	kryesisht
a priori	paraprak
a posteriori	pasues
bona fide	mirëbesim
de facto	sipas faktit
de jure	sipas ligjit
ex tunc	që nga fillimi
ex nunc	që nga ky moment
ex aequo et bono	sipas ekitesë ² dhe së mirës publike
ex proprio motu	me iniciativë vetjake

4. Shtetet

- **Shtet/Shtet Anëtar:** Shkruani gjithmonë “Shtet Anëtar” jo “shtet anëtar” ose “Shtet anëtar” ose “shtet Anëtar”. Shmangni përdorimin e shkurtimit “SHA”.
- Shmangni përdorimin e shkurtimit “SHA”. Nëse përdorni shkurtimin “SHA”, sigurohuni që të përfshihet në listën e shkurtimeve të dokumentit që po përgatitni. Shkruani “Shtet” jo “shtet”, kur u referoheni vendeve anëtare. Ky rregull nuk zbatohet kur u referoheni shteteve në përgjithësi ose shtetit shqiptar.

Emërtimet dhe shkurtimet që duhen përdorur

- Emrat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian gjithmonë shkruhen dhe përdoren në formë të shkurtuar, duke ndjekur parimet e mëposhtme:

2. Parim i njohur në rendin juridik shqiptar me vendimin nr. 15, datë 15.04.2010 të GJK-së. (Gjegjësisht përkundër të drejtës).

- Përdoret kodi ISO me dy shkronja, me përjashtim të Greqisë dhe të Mbretërisë së Bashkuar, për të cilat rekomandohen shkurtime EL dhe UK (në gjuhën angleze), MB (në gjuhën shqipe);
- Rendi protokollar i shteteve anëtare ndjek rendin alfabetik të emërtimeve gjeografike në gjuhën origjinale.
- Mos përdorni “Republika e Irlandës” ose “Republika Irlandeze”.
- Përdorni “Vendet e Ulëta” jo “Holanda”, e cila është vetëm një pjesë e “Vendeve të Ulëta” (provincat e Holandës Veriore dhe Jugore).
- Përdorni “Mbretëria e Bashkuar” jo “Britania e Madhe”, e cila përfshin Anglinë, Skocinë dhe Uellsin; këto të tria së bashku me Irlandën e Veriut janë pjesë përbërëse e Mbretërisë së Bashkuar.

Emri shkurt në gjuhën angleze/shqipe (emërtimi gjeografik)	Emri zyrtar në gjuhën angleze/shqipe (emri i protokollit)	Kodi i shtetit
Belgium (Belgjikë)	Kingdom of Belgium (Mbretëria e Belgjikës)	BE
Bulgaria (Bullgari)	Republic of Bulgaria (Republika e Bullgarisë)	BG
Czech Republic (Republika Çeke)	Czech Republic (Republika e Çekisë)	CZ
Denmark (Danimarkë)	Kingdom of Denmark (Mbretëria e Danimarkës)	DK
Germany (Gjermani)	Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë)	DE
Estonia (Estoni)	Republic of Estonia (Republika e Estonisë)	EE
Ireland (Irlandë)	Ireland (Irlandë)	IE

Greece (Greqi)	Hellenic Republic (Republika e Greqisë)	EL
Spain (Spanjë)	Kingdom of Spain (Mbretëria e Spanjës)	ES
France (Francë)	French Republic (Republika e Francës)	FR
Croatia (Kroaci)	Republic of Croatia (Republika e Kroacisë)	HR
Italy (Itali)	Italian Republic (Republika e Italisë)	IT
Cyprus (Qipro)	Republic of Cyprus (Republika e Qipros)	CY
Latvia (Letoni)	Republic of Latvia (Republika e Letonisë)	LV
Lithuania (Lituani)	Republic of Lithuania (Republika e Lituanisë)	LT
Luxembourg (Luksemburg)	Grand Duchy of Luxembourg (Dukati i Madh i Luksemburgut)	LU
Hungary (Hungari)	Republic of Hungary (Republika e Hungarisë)	HU
Malta (Maltë)	Republic of Malta (Republika e Maltës)	MT
Netherlands (Vendet e Ulëta)	Kingdom of the Netherlands (Mbretëria e Vendeve të Ulëta)	NL
Austria (Austri)	Republic of Austria (Republika e Austrisë)	AT
